

## Lorik Cana viziton te miturit ne Institutin e Kavajes

Friday, 28 May 2010

Një prej futbollistëve më popullorë të Kombëtares shqiptare, mesfushori Lorik Cana vizitoi të miturit që vuajnë dënimin në Institutin e Kavajës, një institut ku CRCA po zbaton programin &ldquo;Qielli është për të gjithë&rdquo; që synon riintegrimin e të miturve të dënuar. Cana, i cili shoqërohej në këtë vizitë edhe nga përfaqësues të UNICEF, i takoi personalisht të miturit që vuajnë dënimin në atë ambient dhe dëgjoi nga ta historitë e tyre personale. &ldquo;Këta të mitur&rdquo;, tha futbollisti i kombëtares, i cili luan aktualisht me fanellën e Sunderland, &ldquo;do të jenë nesër jashtë mureve të institutit ndaj shoqëria shqiptare duhet të bëjë maksimumin që ata të riintegrohen si qytetarë të barabartë&rdquo;.

Lorik Cana viziton të miturit në Institutin e Kavajës

Një prej futbollistëve më popullorë të Kombëtares shqiptare, mesfushori Lorik Cana vizitoi të miturit që vuajnë dënimin në Institutin e Kavajës, një institut ku CRCA po zbaton programin &ldquo;Qielli është për të gjithë&rdquo; që synon riintegrimin e të miturve të dënuar.

Cana, i cili shoqërohej në këtë vizitë edhe nga përfaqësues të UNICEF, i takoi personalisht të miturit që vuajnë dënimin në atë ambient dhe dëgjoi nga ta historitë e tyre personale.

&ldquo;Këta të mitur&rdquo;, tha futbollisti i kombëtares, i cili luan aktualisht me fanellën e Sunderland, &ldquo;do të jenë nesër jashtë mureve të institutit ndaj shoqëria shqiptare duhet të bëjë maksimumin që ata të riintegrohen si qytetarë të barabartë&rdquo;.

Drejtori i CRCA Altin Hazizaj shpjegoi për Canën projektin që CRCA po zbaton në këtë institut dhe theksoi se &ldquo;i gjithë qëllimi është që këta të mitur të mund të kuptojnë qoftë dhe përmes lojërave apo programeve të ndryshme rregullat e jetës në mënyrë që kur të dalin jashtë në përfundim të dënimit të mund të integrohen plotësisht në shoqëri&rdquo;.